



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	5
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	6
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	14
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	15
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	17
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin Europian	18
Aneks 4	Investimet publike	20
Aneks 5	Projekte të ndihmës së huaj	21

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve, integrimin kulturor në familjen evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

MTKRS harton dhe koordinon politikat në fushën e turizmit, nëpërmjet investimeve publike në zhvillimin e infrastrukturës, nxitjes së investimeve private, monitorimit të këtij zhvillimi, edukimit në turizëm, mbrojtjes dhe zhvillimit të potencialeve natyrore, në shërbim të turizmit, si dhe promovimit të vendit si destinacion turistik.

MTKRS harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose jo materiale, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi si dhe për rininë dhe sportet.

MTKRS harton projektligje dhe propozon ndryshime në to për fushat që mbulon, për sistemin e institucioneve në varësi të saj, si dhe ndjek zbatimin e tyre me synim reformimin e vazhdueshëm të strukturave, në funksion të përsosjes së administrimit të fondeve publike, që i akordohen këtij institucioni dhe sistemit në vartësi.

MTKRS bashkëpunon me shoqata jofitim prurëse në fushat e turizmit, kulturës, artit, rinisë dhe sporteve. Në funksion të përmbushjes së misionit, mbështet financiarisht subjekte fizikë dhe juridikë, për organizimin e aktiviteteve kulturore, artistike, për rininë dhe sportin, jep ndihmë në koordinimin e aktiviteteve dhe programeve ndërmjet subjekteve që zhvillojnë veprimtari në këto fusha, brenda Shqipërisë dhe jashtë saj, nxit dhe afron mbështetje për shkëmbime kulturore e sportive me institucione të huaja, shtete dhe subjekte të ndryshme.

MTKRS menaxhon buxhetin e caktuar vjetor, në funksion të misionit, gjithnjë me qëllim administrimin sa më të mirë dhe sa më transparent të fondeve publike, krijimin e nje mjedisi të shëndetshëm për të gjitha komunitetet artistike, kulturore, rinore dhe sportive, për ushtrimin e veprimtarive individuale dhe kolektive, të veçanta apo periodike, që të gjitha së bashku të jenë në ndihmë të lartësimit të imazhit të Shqipërisë, integrimin sa më shpejtë në Europë dhe rritjen e cilësisë së jetesës prej burimeve të artit, kulturës dhe aktiviteteve sportive.

MTKRS udhëheq, programon dhe mbështet aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike, rinore dhe sportive brenda vendit, si dhe përfshirjen dhe ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e turizmit

Strategjitë sektoriale e turizmit do të bazohet në dy dokumentat miratuar:

- VKM 517, datë 3.7.2003, strategjia për zhvillimin e turizmit, dhe
- VKM 395, datë 21.6.2006, strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturor dhe natyror

Objektivat kryesore të përcaktuara në to, të cilat lidhen me realizimin e planit të veprimit, synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe krijimin e mekanizmave të përshtatshme për zbatimin e këtij parimi në të gjitha nivelet. Realizimi i adaptimit dhe hartimit të një kudri të ri ligjor, në përputhje me direktivat e BE, krijimi i politikave për një planifikim të qëndrueshëm të zonave turistike, me ndikim të ndjeshëm në përmirësimin e standarteve, si dhe realizimi i veprimeve në fushat e promocionit dhe marketingut për përmirësimin e imazhit të Shqipërisë në tregun ndërkombëtar, përbëjnë treguesit e realizimeve të objektivave strategjike të domosdoshëm për hedhjen e bazave në krijimin e një industrie turistike formale.

Strategjia sektoriale e kulturës

Mungesa e një strategjie për kulturën ka ndikuar së tepërmi në menaxhimin e infrastrukturës kulturore. Është kjo arsyeja që MTKRS e shikon si një prioritet mjaft të rëndësishëm hartimin e një strategjie për kulturën dhe artin, brënda vitit 2007, kjo për arsyen se hartimi i një strategjie të përgjithshme të zhvillimit kulturor, si një rrjet veprimesh do të mundësojë krijimin e një mjedisi kulturor të ri, konform standarteve europiane. Një dokument i tillë ka për qëllim orientimin e institucioneve të kulturës dhe arteve drejt pavarësisë, kompeticionit dhe rritjes së rolit shumëdimensional në jetën qytetare, demokratike dhe ekonomike të vendit.

Po kështu ka për qëllim nxitjen e marrëdhënieve ndërkombëtare në rritjen e nivelit të njohjes së kulturës shqiptare, si një prej faktorëve më të rëndësishëm të komunikimit dhe si faktor nxitës në integrimin European. Implementimi i një strategjie kulturore është faktor i rëndësishëm sepse i hap rrugë hartimit të planeve të veprimit, me anë të të cilave MTKRS do mund të përcaktojë dhe t'u përgjigjet objektivave afatmesëm dhe afatgjatë, për administrimin financimin, menaxhimin e kulturës kombëtare në të gjitha fushat e saj më të rëndësishme. Ky dokument i rëndësishëm duhet të ndërtohet sipas modeleve dhe standarteve europiane duke e konsideruar kulturën si një mekanizëm që do të ndikojë fuqishëm në zhvillimin demokratik të vendit si dhe në riafirmimin e identitetit të tij kulturor brenda rajonit si pjesë përbërëse e identitetit kulturor europian.

Strategjia ndërsektoriale e rinisë

Strategjia Kombëtare e Rinisë është miratuar me VKM Nr. 782, datë 16.11.2006. Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2007-2013 përbëjnë prioritetin e punës së Drejtorisë së Koordinimit të Politikave Rinore në MTKRS. Ajo është një program që synon krijimin e një mjedisi mundësues, që siguron pjesëmarrjen e të rinjve në formulimin e politikave dhe procesin e vendimtarjes në nivel kombëtar. Politikat rinore të përfshira në këtë strategji vënë në qendër të tyre hartimin e tyre si politika ndërsektoriale, të gjithanshme dhe me vizion afatgjatë. Nëpërmjet kësaj strategjie qeveria shqiptare paraqet politika rinore kombëtare integruese, duke ua adresuar këtë të rinjve dhe çështjeve të lidhura me ta. Kjo do të realizohet si pjesë e një procesi të vazhdueshëm të rishikimit dhe vlerësimit të situatës së të rinjve, zbatimit të programit rinor kombëtar veprimi ndërsektorial në terma specifike të objektivave të përcaktuara në kohë, si edhe një vlerësimi sistematik të arritjeve të kryera dhe vështirësive të hasura.

Strategjia Kombëtare e Rinisë është hartuar në përputhje me:

- programin e qeverisë shqiptare si dhe Paktit të Stabilitetit që ka një rëndësi të veçantë për reformat në të gjithë vendin
- programet dhe projektet rinore të vendeve të Europës duke u përqendruar në strategjitë parësore të zhvillimit, përshjtatur më afër realitetit të rinisë shqiptare
- detyrimet e dala nga Programi Kombëtar për zbatimin e MSA si edhe me rekomandimet dhe zhvillimet bashkëkohore të Forumit Rinor European
- urdhërin e Kryeministrit Nr.134 , “Për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”

Drejtimet kryesore të kësaj strategjie janë koordinimi ndërsektorial dhe angazhimi i përbashkët, përfaqësimi dhe pjesëmarrja rinore, të rinjtë dhe ekonomia, shëndeti dhe mbrojtja sociale, rekreacioni dhe koha e lirë, dhe të rinjtë shqiptarë si qytetarët e rinj europianë.

Qëllime

Politika është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Udhëheqja dhe mbështetja e procesit të ristrukturimit të sistemit të MTKRS-se, në tërësi komponentet e tij të veçanta dhe në bashkëpunim të ndërsjellë, midis turizmit, trashëgimisë, artit, kulturës e sportit, në funksion të krijimit të kushteve dhe një mjedisi të favorshëm për të ndikuar në mënyrë të drejteperdrejte në zhvillimin e tyre.
- Ruajtja, restaurimi i trashëgimisë shpirtërore dhe materiale. Menaxhimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, katalogizimi dhe dixhitalizimi i objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore. Lufta kundër trafikut ilegal të pasurive të trashëgimisë kulturore.
- Shumfishimi i buxhetit për kulturën, por njëkohësisht dhe ngritja e fondeve nga donatorët, organizatat ndërkombëtare si dhe nga burimet e brendshme private për të siguruar konservimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, mbështetjen, promovimin dhe njëherësh dhe mbrojtjen e arteve, krijuesve dhe veprës së tyre dhe garantimin e pronësisë intelektuale.
- Permiresimi i legjislacionit sportiv dhe përafrimi i tij me legjislacionin e BE-se për mirëmbajtjen e organizatave sportive si dhe subjekteve të interesuara dhe permiresimi i promovimit me cilësori të sportit dhe motivimit të tij. Ngritja e një Qendre Sportive Kombëtare për grumbullimin e sportistëve cilësor, duke rritur cilësinë e shërbimit të ofruar dhe rritjen e cilësisë sportive nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës sportive (rikonstruksioni i ambienteve sportive në 90% të qendrave ekzistuese. Permiresimi i rezultateve në sporte të veçanta duke synuar rritjen e mëtejshme të autonomisë financiare të organizatave sportive kombëtare dhe stimulimi i përfshirjes së biznesit në sport. Vëzhgimi sistematik i parametrave teknike dhe fizik të sportistëve cilësor dhe atyre të prespektivës, për të vlerësuar gjendjen aktuale dhe për të mundësuar hartimin e programeve në shërbim të sistemit sportiv kombëtar.
- Adaptimi dhe zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregulloreve perkatese për turizmin në përrputhje me legjislacionin e BE dhe OBT. Permiresimi i sistemit të planifikimit të zonave turistike (duke përfshirë aspekte të integruara ekonomike-sociale-mjedisore), permiresimin e produktit turistik ekzistues, si dhe zhvillimi i llojeve të ndryshme të produkteve në standarte të konkurrenceshme, të afta për promovim dhe marketing. Permiresimi i imazhit turistik të Shqipërisë. Realizimi i marketingut dhe promovimit të turizmit shqiptar me synim krijimin e imazhit dhe identitetit të turizmit shqiptar dhe të pozicionimit të Shqipërisë në tregun ndërkombëtar si destinacion turistik i interesit të veçantë të kombinuar me forma të tjera të turizmit të plazhit dhe biznesit.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston në udhëheqjen dhe mbështetjen e procesit të rikonstruksionit të sistemit të MTKRS-së në tërë komponentët e tij, të ktijimit të kushteve dhe të një mjedisi të dobishëm për të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e tyre.

3.2 TRASHËGIMIA KULTURORE, MUZETË DHE KULTET

Drejtoria e Trashëgimise Kulturore, DTK, dhe institucionet kombetare ne varesi te saj mbeshtetur ne strategjine dhe Programin e Qeverise, ngarkohen me ligj per ruajtjen, restaurimin, mbrojtjen, manaxhimin dhe katalogimin e trashëgimise kulturore materiale dhe shpirtore. DTK koncepton dhe realizon reformen ne institucionet kombetare te trashëgimise kulturore ne bashkepunim me organizmat nderkombetare, integron trashëgimine kulturore shqiptare si pjese te kultures boterore dhe bashkepunon ne luften kunder trafikut ilegal.

3.3 ARTI DHE KULTURA

Politika e ketij programi konsiston ne mbrojtjen, forcimin dhe shpalosjen e identitetit kombëtar, përkundrejt sfidave të tregut dhe në veçanti të ekspansionit globalist, parimi bazë i politikës së qeverisë.

3.4 ZHVILLIMI I SPORTIT

Politika e këtij programi konsiston në hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore në fushën e sportit, duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, duke krijuar kushte ligjore, financiare dhe të infrastrukturës. Administrimi i objekteve nën juridiksion, financimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e mjediseve sportive. Hartimi i akteve nënligjore duke mbështetur në këtë mënyrë organizatat sportive, për përjashtimin e tyre nga detyrimet doganore. Financimi i projekteve sportive dhe mbështetja e organizave sportive me fonde për krijimin e kushteve sa më të mira për sportin si dhe për cilësi sportive sportive ashtu edhe për bazë materiale. Përmirësimi i infrastrukturës sportive jo vetëm nëpërmjet alokimit të fondeve të pushtetit vendor për rikonstruksione të objekteve sportive në administrim të këtyre të fundit, por edhe me ndërtime të reja të mjediseve sportive, sipas standarteve të duhura.

3.5 ZHVILLIMI I TURIZMIT

Politika e ketij programi konsiston ne zhvillimin e qendrueshem te turizmit i cili ruan dhe zhvillon trashëgimine kulturore dhe natyrore te Shqiperise, duke siguruar sukses dhe rritje te shpejte ekonomike. Arritja e potencialit turistik nepermjet zhvillimit te produkteve te diellit e te plazhit, te interesit te vecante dhe te biznesit, zhvillimit infrastrukturor, krijimit te nje mjedisi atraktiv, ndermarrjes se veprimeve ndaj ndertimeve abuzive, si faktore te rendesishem ne suksesin e turizmit. Rendesit e vecante ka permiresimi i planifikimit urban te zonave turistike dhe aktivitetet promociionale dhe te marketingut.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrohet produktet të mëposhtme në 2007. Këto produktet konsistojnë Plani i Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Rikonstrukcioni i aparatit të Ministrisë. Kompletimi i drejtorive të politikave me specialistë në fushën juridike dhe ekonomike, për të mundësuar hartimin e buxheteve të tyre, detyjimin dhe ndjekjen operative të zbatimit të buxheteve të institucioneve të varësisë si dhe ndjekjen e shoqërive anonime me kapital shtetëror.
- Pajisja me programet informatike të nevojshme financiare për evidentimin e pasqyrave financiare të konsoliduara periodike.
- Vendosja e rrjetit të internetit në të gjitha institucionet e varësisë të MTKRS-së, në të cilat mungon kjo lidhje dhe trajnimi i personelit.
- Ngritja e Zyrës Shqiptare për të drejtat e autorit.

Produktet që do të ofrohen

- Organizimi
- Legjislacioni
- Monitorimi

4.2 TRASHËGIMIA KULTURORE, MUZETË DHE KULTET

Objektivat e politikës

- Vënia në efikasitet e parqeve arkeologjike kombëtare dhe rikonceptimi i strukturave të muzeve kombëtare në funksion të strategjisë së turizmit kulturor.
- Restaurimi i monumenteve të kulturës të kategorisë së parë si dhe i objekteve të kultit.
- Mbrojtja e trashëgimisë shpirtërore përmes festivaleve tipologjike dhe formave të tjera të ruajtjes së kësaj trashëgimie.
- Katalogizimi dhe krijimi i fondit muzeor kombëtar.

Produktet që do të ofrohen

- Rijetëzimi i Qendrave Historike të qyteteve ktuesore shqiptare dhe i Parqeve Kombëtare Arkeologjike të Shkodrës, Apollonisë, Amantias, Orikumit, Bylisit dhe Antigonesë.
- Hartimi i planeve afatgjatë të menaxhimit të Qendrave Historike “Pasuri kulturore e njerëzimit mbrojtur nga UNESCO” (Gjirokastër dhe Berat, në pritje), të Parqeve Kombëtare Arkeologjike dhe të Parkut Kombëtar të Butrintit për vitet 2007-2017
 - Ngritja e grupeve të punës për hartimin e draft planeve të menaxhimit
 - Mbështetja e projekteve të trashëgimisë kulturore në funksion të realizimit të plotë të këtyre planeve
 - Botimi i në dy gjuhë i Planeve të Menaxhimit për Qendrave Historike dhe Parqeve Kombëtare Arkeologjike
- Krijimi i itinerareve turistike mes Parqeve Arkeologjike dhe atyre të Qendrave Historike për sezonin turistik 2007

- Ngritja e grupeve të punës për hartimin e draft itinerareve
- Bashkëpunimi mes Institucioneve qendrore të trashëgimisë dhe atyre vendore për organizimin e guidave dhe të gjithë infrastrukturës për këto kategori monumentesh
- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta, programeve televizive të karakterit publicitar, pjesmarrje në panaire vendase dhe të huaj për të popullarizuar këtë produkt të turizmit kulturor
- Shpallja e Beratit si “Pasuri kulturore e njerëzimit e mbrojtur nga UNESCO”
 - Përfundimi i procedurave për dorëzimin dosjes në UNESCO-s për marrjen e statusit të Beratit “Pasuri kulturore e njerëzimit e mbrojtur nga UNESCO”
 - Krijimi i Zyrave të Administrimit dhe Koordinimit të qyteteve muze të Gjirokastrës dhe Beratit
- Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore.
 - Përfundimi i paraqitjes së të gjitha Rregulloreve dhe VKM për qendrat, hartat, ansamblet historike
 - Hartimi i draft marrëveshjeve vjetore mes anëtarëve të BKPKB, BJPA dhe ZAKPA-ve
 - Hartimi i Kartës Shqiptare të Restaurimeve nga grupi i punës i formuar për këtë qëllim
 - Përgatitja e manualit teknik të punës në muzetë kombëtarë, vendorë dhe tipologjikë
 - Ndjekja e zbatimit të Konventave të UNESCO-s për trashëgiminë shpirtërore dhe diversitetin kulturor
- Përmirësimi i punës në Bordet ndërminstrore si: Bordi i Parkut Kombëtar të Butrintit, Bordit Kombëtar të Parqeve Arkeologjike, Këshillit Shtetëror të Muzeve, Këshillit Kombëtar të Restaurimeve
 - Rritja e efektivitetit dhe ndërbashkëpunimit mes antarëve institucionale në Bordet Ndërminstrore
 - Krijimi i Bordeve të reja si Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore
 - Publikimi i veprimtarisë së Bordeve ndërminstrore në Almanakun e MTKRS-së dhe në webin: www.mtkrs.gov.al
- Përmirësimi dhe administrimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit në fushën e Trashëgimisë, ndër të tjera me KE, seksionin e Trashëgimisë, UNESCO, ICCROM, IMC/UNESCO, CIOFF si dhe organizmat e tjera ku jemi anëtarë.
 - Grumbullimi i një informacioni sa më të gjerë mbi zhvillimet Kulturore në Europë e më gjërë;
 - Vënia në dispozicion e këtij informacioni bashkësisë artistike-kulturore.
 - Rritja e marrëdhënieve dhe shkëmbimeve Kulturore me vendet e rajonit e më gjerë;
 - Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit
 - Hartimi i projekteve të përbashkëta si: me Cooperazione Italiana; me INTEREG; me ARCI, Itali; me Trashëgimi pa Kufij, France; me qeveri të ndryshme mike etj
- Botimet dhe publikimet e informacioneve në fushën e trashëgimisë kulturore
 - Hartimi i politikave afatgjata në funksion të qarkullimit barëkombëtar të vlerave
 - Propozime për ndryshime të mundshme të skemës së organizimit aktual etj.
- Përfundimi i procesit të ristrukturimit të Muzeut Historik Kombëtar
 - Dalja e Urdhërit të Kryeministrit për ngritjen dhe përbërjen e grupit të punës
 - Realizimi i Muzeut “Nënë Tereza” në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar

- Mbrojtja e vlerave kulturore lokale, që administrohen nga pushteti vendor
 - Respektimi i legjislacionit
 - Nxjerrja e Udhezimeve për fushat specifike
 - Venia në mbrojtje shtetërore e monumenteve të rinj të trashëgimisë në gjithë vendin
 - Regjistrimi dhe katalogimi i pasurive lokale
 - Ngritja e projekteve të përbashkëta për mbrojtjen, ruajtjen dhe propagandimin e këtyre vlerave
- Trashëgimia kulturore dhe trafiku ilegal
 - Studimi i gjendjes aktuale të institucioneve të ruajtjes së kujtesës katalogimi i veprave të trashëgimisë kulturore
 - Gjetja e mundësive financiare të realizimit praktik të dixhitalizimit
 - Zhvillimi i konferencës ndërkombëtare për dixhitalizimin dhe katalogimin informatik të pasurive kulturore
 - Standartizimi i të gjithë skedave të regjistrimit në mënyrë të veçantë të atyre të trashëgimisë shpirtërore
 - Procesi i kartelizimit të objekteve kulturore jashtë skemës së MTKRS si p.sh në Akademinë e Shkencave, institucione fetare dhe persona juridike apo fizike private
 - Perfundimi i programit kompjuterik eksperimental ONUFRI on-line
 - Trainimi informatik për plotësimin kompjuterik të kartelave etj.
 - Bashkëpunim me organet e specializuara
 - Futja e teknologjive të reja të informacionit
 - Katalogimi dixhital i pasurive kulturore etj.
- Afirmimi i vlerave të trashëgimisë sonë kulturore, jomateriale dhe materiale.
 - Organizimi i panairëve, seminarëve dhe ekspozitave kombëtare ndërkombëtare për evidentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore shqiptare
 - Qarkullimi i grupeve folklorike dhe pjesëmarrje e tyre në aktivitetet botërore të trashëgimisë shpirtërore etj.
- Nxitja e turizmit kulturor
 - Ndjekja dhe zbatimi i marrëveshjeve dhe programeve të shkëmbimeve kulturore me vendet për të cilat ka interes
 - Lidhja e marrëveshjeve dhe nënshkrimi i programeve të shkëmbimeve kulturore me ato vende për të cilat ka interes
 - Hartimi dhe mbështetja e projekteve të përbashkëta me Ministrinë e Linjës, biznesin vendas dhe institucionet ndërkombëtare të fushës
 - Rritja e marrëdhënieve dhe shkëmbimeve kulturore me vendet e rajonit në funksion të trashëgimisë kulturore
- Shndërrimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore në qendra të hapura kulturore për publikun dhe në funksion të turizmit kulturor
 - Organizimi i veprimtarive kombëtare të Trashëgimisë në ambjentet e monumenteve të Trashëgimisë, si kala, ambjente karakteristike, sheshe të hapura etj.
 - Aplikimi i metodave bashkëkohore të menaxhimit të çdo lloji kategorie të monumenteve dhe hapja e tyre për publikun e gjere

- Ndjekja e problematikes specifike te monumenteve në Qendrat Historike dhe Parqet Kombetare Arkeologjike dhe mbajtja e kontakteve te vazhdueshme me IMK
- Paketa e veprimtarive kombetare te Trashegimise Kulturore
 - Hartimi dhe përmirësimi i statuteve te Festivaleve te pervitshme Tipologjike Folklorike Kombetare
 - Bashkëpunimi me pushtetin vendor per organizimin e tyre
 - Hartimi i kriterëve shkencore te organizimit te tyre etj.
 - Hartimi i projekteve te plota per ç’do veprimtari kombetare etj.
- Paketa e aktiviteteve kombëtare dhe vendore të Turizmit Kulturor dhe mbështetje e rëndësishme financiare per projektet kombëtare në bashkëpunim me të tretët
 - Festivali Kombëtar i veglave të Muzikës Popullore, Gjirokastër
 - Festivali Folklorik Ndërkombëtar “Përmeti Multikulturor”
 - “Oda Dibrane”
 - “Sofra dardane”, Tropojë
 - Panairi kombëtar i zejeve dhe traditave etnografike

4.3 ARTI DHE KULTURA

Objektivat e politikës

- Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e artit dhe kulturës.
- Rishikimi i vendimeve që ndihmojnë në mbështetjen financiare të projekteve.
- Hartimi i ligjeve që rregullojnë funksionimin e institucioneve të kulturës.

Produktet që do të ofrohen

- Përmirësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor në fushën e artit dhe kulturës së shkruar
 - Hartimi i akteve nënligjore në përputhje me ligjin “Për artin skenik”: hartimi i vendimit për ngritjen e Qendrës së Artit Skenik; hartimi i vendimit për bashkimin e dy institucioneve TKOB dhe AKVP; miratimi i statuteve të institucioneve sipas këtij ligji
 - Hartimi modaliteteve lidhur me kriteret e aplikimit që ndihmojnë në mbështetjen financiare të projekteve dhe mirëfunksionimi i veprimtarisë kulturore sidomos në drejtim të nxitjes së iniciativës private kërkon rishikimin konkret si: miratimin e udhëzimit për mënyrën e aplikimit dhe rishikimin e VKM nr.309, viti 1993 “Për përcaktimin e tarifave për shpërbllimin e cilësisë artistike”, sipas ligjit për artin skenik
 - Amendimi i ligjit 8576, datë 3.2.2000 “Për bibliotekat në R.Sh.”, në funksion të ligjit Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për librin në R.Sh.”: ngritja e grupit të punës me specialistë të MTKRS e BK; bashkërendimi i punës me institucionet e linjës; paraqitja për miratim tek instancat eprorë; hartimi i draftit përfundimtar; paraqitja për miratim në Këshillin e Ministrave
 - Miratimi i akteve nënligjore të ligjit Nr. 9616, datë 27.09. 2006 “Për librin në R.Sh.”: përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të licensimit të botuesve dhe krijimi i regjistrit të botuesve të licensuar
 - Hartimi i strategjisë për kulturën si një faktor i rëndësishëm që i hap rrugë hartimit të planeve te veprimit, me anë të të cilave MTKRS do mund të përcaktojë dhe t’u përgjigjet objektivave afatmesëm dhe afatgjata, për administrimin, financimin dhe menaxhimin e kulturës kombëtare në të gjitha fushat e saj më të rëndësishme: krijimi i grupit të punës, tërheqja e mendimit të aktorëve të interesuar, dhe prezantimi i projekt platformës për miratim

- Mbrojtja, forcimi dhe shpalosja e identitetit kombëtar për ruajtjen e vlerave kombëtare, duke mbështetur kryesisht institucionet kombëtare të artit dhe kulturës. Do të ngrejë Shkollën Kombëtare të Filmit dhe Arkivit Qendror të Filmit në një njësi territoriale të emërtuar Qyteti i Filmit, brenda vitit.
- Përmirësimi i imazhit të vendit nëpërmjet përcjelljes së vlerave kulturore, turistike e historike si dhe promovimit të turizmit kulturor nëpërmjet shkëmbimeve të ndërsjellta të këtyre vlerave (përfshihen projekte të artit skenik, artit vizual dhe kulturës së shkruar)
- Përmirësimi i infrastrukturës në fushën e artit dhe kulturës së shkruar do të synohet finalizimin e ngritjes së qendrës së artit skenik dhe finalizimin e ndërtimit të Teatri të ri Kombëtar

4.4 ZHVILLIMI I SPORTIT

Objektivat e politikës

- Hartimi, rishikimi dhe përmirësimi i legjislacionit sportiv, në bashkëpunim me organizatat sportive, institucionet shkencore dhe ato të interesuara. Forcimi i demokracisë në sistemin sportiv nëpërmjet përsosjes së funksionimit të organizatave sportive, përsosjes së dokumentave themelore të tyre.
- Studimi nga ekspertë dhe në bashkëpunim me pushtetin vendor i gjendjes së terreneve sportive në 100% të territorit të Shqipërisë, përfshirë edhe atyre të shkollave, për të krijuar një ide më të qartë mbi këto terrene, për të vijuar më tej me studime apo plane konkrete rikonstruksioni. Bazuar mbi përvojën e viteve të kaluara, plani i investimeve do të jetë 12 objekte në rikonstruksion, 3 objekte për ndërtim të plotë.
- Rritje e numrit të pjesëmarrësve në sport, rritje e vlerave promovuese dhe edukative në aktivitete sportive dhe lokalë, me synim gjithpërfshirjen e popullsisë në sport.

Produktet që do të ofrohen

- Përmirësimi i legjislacionit dhe thellimi i reformës institucionale. Forcimi i demokracisë në sistemin sportiv nëpërmjet përsosjes së funksionimit të organizatave shqiptare të sportit, përsosjes së dokumentave themelore të tyre, (statute, rregullore) për një mirëqeverisje dhe mirëmenaxhim të strukturave sportive dhe buxhetit financiar të tyre.
 - Hartimi dhe institucionalizimi i statutit tip për organizatat dhe shoqatat sportive kombëtare
 - Përfundimi i rishikimit dhe amendimeve në Ligjin “Për Sportin” Nr. 9376, datë 21.04 2005
 - Përmbledhja dhe botimi në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) të dokumente themelore të legjislacionit sportiv shqiptar
- Përsosja e mardhënieve financiare në nivelin e organizatave sportive. Në mënyrë që sporti t’i shërbejë sa më mirë misionit të vet për një nivel elitare cilësor dhe masiv, bbremda dhe ajshtë vendit, në përpjekje për të minimizuar abuzimet dhe keq-përdorimet e fondeve buxhetore, do të synojë në sa më poshtë.
 - Hartimi i një buxhetit grant për Federatat Sportive Kombëtare mbi bazën e arritjeve të vitit 2006 dhe plotësimit të standarteve të federatave ndërkombëtare sportive
 - Nxitja e strukturave sportive për projekte konkrete
 - Stimulimi i përfshirjes së biznesit vendas dhe thithjes së donacioneve të huaja në sport
 - Rritja e kapaciteteve menaxhuese të organizatave sportive nëpërmjet seminareve
- Rritja e imazhit të sportit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në zbatim të angazhimeve dhe detyrimeve që burojnë nga integrimi në strukturat sportive rajonale dhe të marrëveshjeve dypalëshe, Drejtoria e Sportit për vitin 2007 synon:

- Implementimi i Planit Ekzekutiv të bashkëpunimit me Administratën e Përgjithshme të Sporteve të RP të Kinës
- Hartimi i një Programi Ekzekutiv për realizimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë Turke të Sporteve
- Antaresimi në Marrëveshjen e Pjesëme të Zgjeruar (EPAS) të Këshillit të Europës
- Programi sport - Rini. Me synim nxitjen e sportit për fëmijë dhe për të rinj, duke u bazuar në dëshirat, shprehjet, aftësitë dhe nevojat e tyre, por dhe me objektivin për një sport të qendrueshëm dhe cilësor, Drejtoria e Sportit do të realizojë për këtë vit:
 - Programi për zhvillimin e talenteve të rinj në sport për vitin 2007, mbi përvojën e programit pilot Talenti 2006
 - Pjesëmarrja për herë të parë të sportistëve të rinj shqiptarë në Lojrat e para Sportive të Detit të Zi, Trabzone/Turqi më 2 - 8 Korrik 2007 me një delegacion rreth 80 vetë
 - Pjesëmarrja e Ekipit Sportiv Shqiptar në Lojrat e para të Europës Jug Lindore, në Athinë
 - “Kryeqyteti Shqiptar i Sportit për Vitin 2007” në kuadër të festimeve të 95 vjetorit të Pavarësisë, në Prishtinë/Kosovë në Nëntor 2007
 - Në kuadër të zgjerimit të nismës “Një Komb - Një Kulturë” realizimi i Programit Integruar Sportiv Tiranë - Prishtinë - Shkup me aktivitete sportive
- Sporti për të gjithë. Duke e vlerësuar sportin dhe aktivitetin fizik si çështje me interes publik dhe si faktor edukativ shëndetësor dhe argëtues për të gjitha moshat, prioritet do të marrin veprimtaritë masive sportive me përfshirjen e të gjithë grup moshave.
 - “Riorganizimi i Sportit në Shkollë” në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës
 - Panairi Sportiv i Fëmijëve në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve
 - “Maratona e Popujve” në kuadër të Ditës së Lumturimit të Nënë Terezës
 - Organizimi i kampionateve të basketbollit dhe futbollit midis skuadrave të universiteteve dhe shkollave të mesme, me synim për ta kthyer në traditë (në bashkëpunim me Drejtorinë e Rinisë); shpenzimet për këto veprimtari do të jenë nga buxheti i shtetit (bashkëpunim me MASH)
- Infrastruktura sportive. Në vijim të punës për përmirësimin e infrastrukturës sportive të nisur gjatë vitit 2006 si dhe me synim nxitjen e turizmit sportiv me moton “me sportin - për komunitetin” do të vazhdojë puna për:
 - Finalizimin e projektit austriak për ndërtimin e ski-pistës dhe resortit turistik dimëror në Dardhë të Korcës (nëntor 2007; nga buxheti në bashkëpunim me ministrinë e linjës)
 - Ndërtimin e 9 objekteve të reja sportive dhe rikostruksionin e 4 objekteve të tjera në të gjithë vendin.

4.5 ZHVILLIMI I TURIZMIT

Objektivat e politikës

- Promocioni dhe pozicionimi i Shqipërisë si destinacion turistik i interesit të veçantë në tregun ndërkombëtar duke synuar tërheqjen e turistëve me të ardhura të mesme të larta
- Promocioni i Shqipërisë si destinacion turistik i plazhit në trojet etnike jashtë kufirit duke synuar në rritjen e numrit të vizitorëve shqiptarë etnikë me 20-30%
- Zhvillimi i konceptit të turizmit të qendrueshëm nëpërmjet miratimit të strategjisë së turizmit kulturor, ndërthurja e produkteve të turizmit, përmirësime në legjislacion, ngritja e guidave të sistemit të guidave turistike

- Rishikimi i studimeve urbanistike dhe zgjidhja e situacioneve të zhvilluara abuzivisht në zonat turistike. Ngritja e cilësisë së shërbimit në strukturat turistike. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare të OBT-së.

Produktet që do të ofrohen:

- Rritja e numrit të turistëve me masen 15% - 20%
- Miratimi i projektligjit “Për turizmin”
- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për turizmin”
 - VKM për shpalljen e zonave, vendeve dhe pikave turistike
 - VKM për organizimin dhe funksionimin e AKT
 - VKM për kushtet dhe kriteret e përfitimit të asistencës financiare
 - VKM, për standartet, kriteret, rregullat e licensimit, procedurat për aplikim për licensë, në fushën e turizmit
 - Rregullorja dhe urdhëri përkatës i Ministrit për funksionimin e KKSPT
 - Rregullorja dhe urdhëri përkatës i Ministrit për kriteret dhe procedurat për njohjen e fshatit turistik
 - Urdhër i Ministrit për krijimin e Komisionit të Licensimeve të turizmit
 - Rregullore për kriteret e ndërtimit të hoteleve dhe restoranteve turistike
 - Rregullore për regjistrimin e njësive të akomodimit dhe restoranteve turistike
 - Rregullore për klasifikimin e njësive akomoduese dhe restoranteve turistike
 - Rregullore dhe kriteret për ushtrimin e aktivitetit të agjensive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë, si dhe të dhënies së certifikatës punomjësit dhe ekspertit të udhëtimit
 - Rregullat për licensimin e subjekteve që ofrojnë transport turistik tokësor, ajror dhe ujor
 - Rregullore për kriteret e licensimit të guidave turistike
 - Rregullore për kriteret e funksionimit të sipërmarrjeve turistike
 - Rregullorja e shqyrtimit të ankesave nga ZAT
- Zbatimi i projekteve të programit të UNDP në zbatim të planit të veprimit të Strategjisë së Turizmit Kulturor dhe Mjedisor
 - projekti mbi kërkimin e tregut turistik në Shqipëri dhe përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe përmirësimin e të dhënave statistikore
 - projekti mbi trainimin e guidave turistike
 - projektet “Gjirokastra e bukur” dhe “Berati i bukur”
 - projektin mbi ndërtimin e faqes së internetit, për turizmin shqiptar
- Hartimi i strategjisë për zhvillimin e turizmit rural në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Turizmit
- Analizë e gjendjes së ekstraformalitetit të strukturave të miratuara turistike
- Zhvillimi i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit në Tiranë dhe i Konferencës së Dytë të Biznesit të Turizmit
- Pjesëmarrje në panairët ndërkombëtarë të: Utrecht, Berlin, Milano, Londër
- Botime promovionale mbi turizmin kulturor, si dhe ato të lidhura me tregun turistik kosovar
- Marrja e masave, nëpërmjet bashkëpunimit ndërministror dhe me njësitë e pushteteve vendore të zonave turistike, për një sezon turistik të suksesshëm

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	79	43	0	0	0	6	129
Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet	224	75	0	6	0	133	439
Arti dhe Kultura	365	69	0	33	0	1,166	1,634
Zhvillimi i Sportit	34	21	0	133	0	56	244
Projekte Turistike, Kulturore dhe Sportive	0	0	0	135	0	0	135
Zhvillimi i Turizmit	21	19	0	3	0	25	69
Total	725	227	0	312	0	1,387	2,651

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Rrjeti i internetit në të gjitha institucionet e varësisë së MTKRS-së i instaluar		
Pajisja me programe informatike për pasqyrat financiare		
Numri i aktiviteteve në funksion të ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore		9
Numri i vendimeve të aprovuara		37
Numri i ligjeve të aprovuara		5
Numri i objekteve sportive të rikonstruktuar dhe të ndertuara		13
Numri i vizitoreve të huaj		880 774
Rritja e numrit të vizitoreve shqiptare etnike	%	23

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

Projektligjet që do të përgatiten dhe do të paraqiten për miratim në vitin 2007

1. Projektligji “Për fenë” në Republikën e Shqipërisë

Ky projektligj ka si objekt sigurimin e të drejtës së sejcilit për mos tu diskriminuar në çfarëdo baze dhe me barazi të plotë para ligjit, për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, pavarësisht nga bindja fetare apo vetëdija. Qëllimi i këtij projektligji është vendosja e rregullave dhe normave për organizimin, funksionimin e personave juridikë fetarë, si dhe marrëdhëniet e komunitetit fetar dhe shtetit shqiptar.

2. Rishikimi i ligjit nr. 9376, date 21.04.2005 “Për sportin”

Synon eliminimin e problemeve dhe boshllëqeve të hasura në interpretimin dhe implementimin e ligjit për sportin në drejtim të organizatave sportive, si dhe përcaktim më të qartë mbi rolin e shtetit dhe marrëdhënien e tij me këto organizata.

3. Rishikimi i ligjit “Për bibliotekat”

Ky projektligji ka si qëllim rishikimin, përputhjen dhe harmonizimin që duhet të gjejë ky ligj me ligjin nr. 9616, date 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe plotësimi i vakumit ligjor në lidhjen mes tyre.

4. Projektligji “Për turizmin”

Projektligji “Për turizmin” ofron në menyrë cilesore dhe në përputhje të plotë me standartet e përcaktuara nga Axhenda 21 e Bashkimit Evropian, rregullimin e sektorit dhe mbulimin e një serë aspekteve të patrajtuara nga ligji ekzistues. Vizioni dhe interesi themelor në përgatitjen e këtij drafti është fuqia e tij për të ndihmuar konkretisht zhvillimin e industrisë turistike në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit të turizmit, duke priorizuar dhe lidhur burimet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me zhvillimin e turizmit.

Aktet nënligjore që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në vitin 2007

- Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9631, date 30.10.2006 “Për artin skenik” (hyrë në fuqi me date 10.12.2006)

1. Projektvendimi me titull “Për masën e shpërblimit të anëtarëve të bordit artistik”

2. Projekturdhëri me titull “Për përcaktimin e strukturës organike të Qendrës Kombëtare të Artit Skenik”, i cili do të firmoset nga Kryeministri (neni 15/2 i këtij ligji)

3. Projektvendimi me titull “Për emërimin e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Artit Skenik”

4. Projektvendimi me titull “Për kushtet dhe dheniës së statusit ‘Teatër Metropolitan’” (neni 30 i këtij ligji)

5. Projektvendimi “Për shpërblimin e vlerës artistike në artin skenik dhe për kontributin e angazhimit të perkohshëm në projektet kulturore” (neni 32/1 i këtij ligji)

6. Projektvendimi “Kushtet, kriteret dhe masa e shpërblimit për rezultate të larta, të arritura në konkurime ndërkombëtare, në artin skenik” (neni 32/2 i këtij ligji).

- Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9616, date 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, hyrë në fuqi me datën 10.11.2006
 1. Projektvendimi “Për pasurimin e fondeve të sistemit bibliotekar kombëtar” duke përcaktuar një minimum titujsh librash të botuar dhe të shtypshkruar, i cili do të përcaktohet me vendim të Keshillit të Ministrave.
 2. Projektvendimi “Për procedurat e liçensimit dhe kriteret e cilësive profesionale, kulturore dhe etike të botimit, që duhet të plotesojnë personat fizike e juridike”
 3. Projektvendimi “Për miratimin e rregullorës së funksionimit të Keshillit Kombëtar të Librit”
 4. Projektvendimi “Për krijim e regjistrit të botuesve dhe caktimin e rregullave të regjistrimit dhe çregjistrimit”
 5. Projektvendimi “Për miratimin e rregullorës së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Standartizimit të Librit”
- Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9592, date 27.07.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, date 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore””
 1. Projektvendimi “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimeve” neni 17, pika 7.
 2. Projektvendimi “Për procedurat e konkurimit publik për restaurimet e monumenteve të kulturës nga subjektet private të licensuar për këtë qëllim”, neni 18, pika 2.
 3. Projektvendimi “Për rregullat dhe procedurat e ankandit të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të zakonshme”, neni 20, pika 3.

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin Europian

Qeveria Shqiptare me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ka marrë disa angazhime të rëndësishme në fushën e pronësisë intelektuale, konkretisht të drejtat e autorit për të cilat është përgjegjëse politikisht MTKRS. Detyrimet që dilnin në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit është mbrojtja e pronësisë intelektuale në Shqipëri në nivel të ngjajshëm me Bashkimin Europian, duke lënë një afat kohor për përmbushjen e këtij detyrimi deri në katër vjet (neni 73 i marrëveshjes). Objektivat që u përcaktuan nga MTKRS-ja, për këtë detyrim ishin:

- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit të ri në fushën e pronësisë intelektuale (të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta me të) në përputhje me direktivat dhe standardet e Bashkimit Europian. Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri me nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”. Ky ligj, në vlerësim edhe të Komisionit Evropian:
 - përmirëson ndjeshëm legjislacionin kombëtar që vepron në fushën e pronësisë intelektuale (të drejtat e autorit) në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian
 - pasqyron rekomandimet e bëra nga Komisioni Europian në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (implementimi i direktivave të komunitetit evropian që vepron në këtë fushë në ligjin kombëtar)
 - siguron ngritjen e strukturave administrative për zbatimin e ligjit dhe luftën kundër piraterisë dhe mallrave të fallcifikuara që përbëjnë pronësi intelektuale në tregun shqiptar
- Ngritja e strukturave institucionale për monitorimin dhe zbatimin e ligjit, dhe forcimin e kapaciteteve administrative për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, përfshirë ngritjen e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit. Keshilli i Ministrave në zbatim të ligjit të sipërpërmenduar, me vendim nr.232, date 19.04.2006 ka miratuar vendimin “Per krijimin dhe funksionimin e Zyres Shqiptare per te Drejtat e autorit” (ZSHDA). Qëllimi dhe objekti i ZSHDA-së janë:
 - ZSHDA mbart angazhimin kushtetues të shtetit për të zbatuar të drejtën e autorit në Shqipëri në përputhje me nenin 58 të saj.
 - Kjo zyre do të kryejë funksionin e një rregullatori mes marrëdhënieve ndër-institucionale të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit të ardhshëm si dhe mes vetë palëve private që janë subjekte të këtij ligji.
 - Në këtë zyre do të depozitohen, rregjistrohen e çertifikohen të gjitha llojet e veprimeve juridiko civile që i përkasin fushës së drejtës së autorit.
 - Një funksion tjetër mjaft i rëndësishëm i zyres është edhe shqyrtimi dhe zgjidhja administrative e konflikteve me objekt shkelje dhe cenim të drejtave të autorit.
 - Një funksion tjetër i Zyres është ai që qenit i vetmi organ i specializuar për liçensimin dhe angazhimin e eksperteve të fushave të ndryshme të artit dhe kultures, në veçanti, në ofrimin e njohurive të specializuara gjyqësorit.
 - Gjithashtu ZSHDA do të jetë trajnuese dhe angazhues i strukturave përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve sanksionuese (strukturat tatimore).
 - ZSHDA do të jetë monitoruese e tregut të biznesit artistik; sanksionuese në rast konstatimi të kundërvajtjes administrative.
- Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me njohjen ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri.
- Rritja e efikasitetit të luftës kundër piraterisë dhe mallrave të fallcifikuara të pronësisë intelektuale nëpërmjet forcimit të mekanizmave ligjorë dhe institucional.

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit

ZSHDA është një institucion i ri, i pari i këtij lloji, i cili do të jetë në varesi të MTKRS-së. Struktura dhe organika e ZSHDA-së është miratuar nga Kryeministri me Urdhër nr.214, datë 12.09.2006. Zyra do të ketë një staf prej 11 vetash, specialiste dhe inspektore të cilët do të trajnohen në fushën e të drejtave të autorit. Hapat që do të merren për ngritjen e ZSHDA:

- Emerimi i titullarit të ZSHDA. Paralelisht me procesin e hartimit të strukturës dhe përcaktimit të organikës, janë përcaktuar kriteret për titullarin e ZSHDA, dhe është shpallur konkursi publik për këtë pozitë. Për shqyrtimin e këtyre kërkesave dhe dosjeve të aplikantëve për këtë pozitë të paraqitur, do të mbidhet një komiteti ad hoc i ngritur nga Ministri për përzgjedhjen e kandidaturës së duhur për tja paraqitur Ministri për emërim.
- Përcaktimi i selisë ku do të vendoset ZSHDA
- Buxheti i ZSHDA
- Rekrutimi i stafit të ZSHDA
- Trajnimi i stafit
- Fillimi i funksionimit të ZSHDA në zbatim të ligjit dhe të Vendimit të krijimit të saj, hartimi i rregulloreve të brendshme të saj
- Vendosja e bashkepunimit me institucionet e përfshira në procesin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të autorit.
- Koordinimi i veprimtarisë institucionale në luftën kundër piraterisë dhe falsifikimit, forcave të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit në lidhje me të drejtën e pronësisë intelektuale dhe tregtare.
- Rritja e sensibilizimit të autorëve dhe gjithë kategorive të përfituesve të të drejtave, përdoruesve të veprave artistike, si dhe të shoqatave të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit, mbi problemet dhe shqetësimet e tyre jo në shkallën e duhur.
- Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë, forcave të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit në lidhje me të drejtën e pronësisë intelektuale dhe tregtare.
- Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë (gjithë aktorët e interesuar në këtë fushë) nëpërmjet fushatave sensibilizuese mediatike, publikimeve, dhe seminareve.
- Pajisja e zyrave me logjistiken perkatese të nevojshme për funksionimin e një institucioni të tillë: kompjutera, fotokopje, printer, tavolina, rafta, karrige etj
- Gjithashtu rritja e sensibilizimit për çështjet e pronësisë intelektuale mes bashkësisë së biznesit dhe institucioneve të zbatimit të ligjit përfshirë gjyqësorin.

MTKRS në bashkëpunim me stafin e ZSHDA menjëherë pas ngritjes së saj, do të bashkëpunojnë për:

- Intensifikimin e zbatimit të ligjit kundër piraterisë dhe falsifikimeve (në bashkëpunim me KKRT dhe Drejtorinë e Tatimeve)
- Zbatimin e konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për të drejtën e pronësisë intelektuale, tregtare dhe industriale
- Zbatimin në mënyrë të përshtatshme të së drejtës së pronësisë intelektuale duke shënuar hapa konkrete në fushën kundër piraterisë dhe falsifikimeve
- Forcimin e kapaciteteve administrative siç kërkohen nga MSA për këtë fushë, duke ngritur edhe zyrat rajonale për të drejtën e autorit neper qarqe në vitet 2008-2009

Aneks 4 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	
Blerje pajisjesh	2
TVSH dhe detyrime doganore	4
Trashegimia kulturore, muzetë dhe kultet	
Blerje pajisjesh	5
Restaurimi i shtëpise se Kadares	10
Restaurimi i shtëpise se A. Moisiut	4
Restaurimi i banesës se H.Llujes	2
Restaurime banesash të tjera	13
Restaurime në objekte fetare dhe në afreske	4
Restaurime të kalave (Kruja, Berati, Rozafa, Skela)	7
Restaurime në qytete antike dhe parqe arkeologjike (Teatri Sofratikes, Amantia, Orikum, Antigone, Byllis, Shkodër, Apolloni, Amfiteatri Durres)	25
Restaurime të ndryshme	5
Restaurime dhe ndertime muzeumesh dhe monumentesh	12
Rikonstruksione dhe ndertime qendrash kulturore (Kruje, Poliçan, Laç, Librazhd)	19
Rikonstruksion i godines se Muzeut Historike Kombetar	9
Ndertim i selisë së Institutit të Monumenteve të Kulturës	6
Rikonstruksione dhe ndertime të tjera	8
Shpronësim Muzeu Kruje	5
Arti dhe kultura	
Blerje pajisjesh	6
Monumente dhe buste	37
Studim - Projektme	2
Biblioteka Kombëtare - Rikonstruksion	120
Rikonstruksion i Qendres Nderkombetare të Kulturës Pjeter Arbërori	670
Rikonstruksione në godina të artit dhe kulturës të tjera	14
Zhvillimi i sportit	
Blerje pajisjesh	1
Ndertime të objekteve sportive	39
Rikonstruksione të ambienteve sportive	17
Zhvillimi i turizmit	
Sinjalistike turistike	10
Zyra të informacionit turistik (5 zyra)	15

Aneks 5 Projekte të ndihmës së huaj

Në buxhetin e vitit 2007 është parashikuar investim i huaj për ndërtimin e Teatrit të Ri Kombëtar në vlerën 317.000.000 lekë, donacion i Qeverisë Greke i cili mbartet nga viti në vit.

